



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2419 / 4 prot.

Datë 03.08.2026

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI OFERTUESIT E TJERË

Objekti: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “GENTIAN SADIKU, KOMBI INVEST” ShPK në procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-84755-05-07-2026, me objekt “Furnizim dhe shërbim lavanderie për Qendrën Spitalore Rajonale Berat” me fond limit 122,759,591.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 15-06-2026 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Lënin të skualifikuar të ofertës së operatorit ekonomik UNIVERS SERVIS sh.p.k shpk në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “BOE “GENTIAN SADIKU, KOMBI INVEST” ShPK me NIPT L42314005A dhe K43407402P , Adresa: Rruga At Zef Pllumbi, pallati nr16 Devi 2001 pasuri Nr 39/118-n10 zona kadastrale 2679 vol 31, Me Tiranë, Fier

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Subjekt i Interesuar: Operatori ekonomik UNIVERS SERVIS sh.p.k me Nipt L01703501S, Adresa: Durres Xhafzotaj Fshati Xhafzotaj, godine 1- kateshe, ngjitur me tregun rural i fruta-perimeve..

Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor janë depozituar ankesat me numër ankimimi elektronik A/2026/7109 datë 31.07.2026 prptokolluar me tonen 2419/2024 datë 03.08.2026 dhe ankesa me nr A/2026/7109 datë 31.07.2026 protokolluar me tonen 2419/1/2026 datë 03.08.2026 nga BOE “GENTIAN SADIKU, KOMBI INVEST” ShPK në procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-84755-05-07-2026, me objekt “Furnizim dhe shërbim lavanderie për Qendrën Spitalore Rajonale Berat” me fond limit 122,759,591.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 15-06-2026 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “GENTIAN SADIKU, KOMBI INVEST” ShPK si edhe lenien te skualifikuar te operatorit ekonomik UNIVERS SERVIS sh.p.k në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Bazuar në nenin 112 pika 3 gërmat “b” dhe “c” të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: “3. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon: **b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

- Komisioni i Prokurimit Publik publikon arsyen e skualifikimit të BOE “GENTIAN SADIKU, KOMBI INVEST” ShPK si vijon:

Operatori ekonomik BOE “KOMBI INVEST” & “GENTIAN SADIKU” nuk i përmbush të gjitha kërkesat e veçanta për kualifikim të përcaktuara në DT për këtë fazë të vletësimit (nuk përfshihet verifikimi fizik dhe provues), për këto arsye: 1. Nuk ka plotësuar të dhënat e kërkuara në tabelën sipas pikës 2.3.7 në lidhje Certifikimet CE të Akredituara për produktet produktet e materialeve të buta sipas listës të artikujve të kërkuara shprehimisht në tabelën sipas pikës 2.3.7 dhe Shtojcën 8 të DST Specifikimeve Teknike Arsyetimi Konkretisht në tabelën sipas pikës 2.3.7 është kërkuar “ Operatori ekonomik në lidhje me materialin e butë të përcaktuar në specifikimet teknike, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme: QSRB Nr. Emertimi i produktit Vendi i origjinës Skede teknike/katalog Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar 1-31 Artikujt Në bazë të Dokumentave të Tenderit, pika 2.3.7 e Kërkesave të Vecanta Kualifikuese, shpreh detyrimin për plotësimin e Certifikimeve CE ose Cilësie të Akredituar për artikujt e përcaktuar në Specifikimet Teknike me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë nëse produktet i plotësojnë Specifikimet Teknike të materialeve që do të furnizohen në Spitalin e Beratit në kuadër të kontratës të shërbimit të lavanderisë. Për këtë pikë , në lidhje me Rubrikën “Certifikatë Konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar”

BOE Kombi Invest dhe Gentian Sadiku paraqitën dokumentin elektronik me titull “Deklaratë Origjine dhe Certifikime”, në të cilin kanë plotësuar vetëm deklarinimin “Certifikate Oeko-Tex dhe Deklaratë Konformiteti”, dhe nuk janë plotësuar Certifikimet e Cilësisë CE konkrete, që përmban seicili nga produktet sipas specifikimeve teknike. Ky deklarinim është i pasaktë dhe i pamjaftueshëm për qëllime kualifikimi pasi Dokumentat e Tenderit nuk kërkojnë Deklaratë Konformiteti por vetëm Certifikatë CE ose Cilësie/ ekuivalent të Akredituara. Sqarojmë se argumentat e BOE Kombi Invest & Gentian Sadiku në sqarimet e dhëna për KVO në SPE, se “kjo kërkesë ka të bëjë vetëm me plotësimin me deklarinim të tabelës sipas DST , dhe se nuk kërkon parqitjen e certifikimeve konkrete”, nuk janë të mbështetura në faktet që përmban dokumentacioni i dorëzuar në SPE, pasi vetë këto subjekte kanë paraqitur një volum të madh dokumentacioni provues si Certifikatat OEKO-TEX, Skeda Teknike, Autorizime të Prodhuesit, Certifikatë CE për pantoflat etj, të cilat tregojnë se subjektet e kanë kuptuar qartë qëllimin e kërkesës për evidentimin e Certifikimeve të Cilësisë CE të kërkuara në tabelën 2.3.7, por këto deklarime nuk janë të plota dhe nuk nuk evidentojnë Certifikimet e Cilësisë CE të kërkuara nga tabela 2.3.7.

2.Nuk plotëson dhe nuk vërteton me dokumentacion kapacitetin teknik të kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, për për shërbime/furnzime të ngjashme me objektin e prokurimit, për këto arsye: Arsyetimi Në pikën 2.3.1 Kërkesat e Vecanta për Kualifikim është kërkuar “2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit

të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Për këtë pikë kualifikuese, referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit , BOE Kombi Invest sh.p.k & Gentian Sadiku P.f ka marrë përsipër të kryejë 43 % të kontratës duke deklaruar se do të kryejë furnizimin e materialeve të buta sipas specifikimeve teknike. Nisur nga ky fakt subjekti ka paraqitur si furnizime të ngjashme disa fatutra tatimore shitje realizuar me subjekte private dhe konkretisht: -Fatura Nr.7/2025 me objekt “Carcaf dhe kellef jasketku”, -Fatura Nr. 84/2023 me objekt “Bataniye dhe Carcafë ”, -Fatura Nr.65/2024 me objekt “Kellef jasketku”, -Fatura Nr.3/2025 me objekt “peshqira”, -Fatura Nr.1/2025 me objekt “Carcaf dhe kellef jasteku”. Referuar objektit të këtyre faturave të furnizimit , rezultoi se subjekti pjesëmarrës nuk ka realizuar asnjë furnizim të ngjashëm për zëra të rëndësishëm të furnizimeve sipas kësaj kontrate, përcaktuar në faqen 36-39 të DST , të cilat si në përmbajtje dhe në vlerë kanë rol thelbësor në plotësimin e furnizimeve të ngjashme sipas kësaj kontrate dhe konkretisht.-Antari i BOE Gentian Sadiku P.f Nuk ka realizuar asnjë furnizim të ngjashëm me artikullin dyshek 1 Dyshek 277 2 Dyshek standart per pediatri 64 3 Dyshek neonati 22- Nuk ka realizuar asnjë furnizim të ngjashëm me artikullin “jorgan” dhe “këllëf dysheku i gomuar” 5 Jorgan me vatin 341 6 Këllëf dysheku i gomuar 341- Nuk ka realizuar asnjë furnizim të ngjashëm me artikullin “pandofla” 19 Pandofla pacienti për adultët 110 20 Pandofla pacienti për Pediatri 64 31 Pandofla personeli 370 Sqarim: Shifrat përkrah artikujve janë numri i artikujve të kërkuar nga Spitali për këtë kontratë. Sikurse vihet re qartë se Subjekti pjesëmarrës nuk ka arritur të vërtetojë realizimin e zërave kryesorë të ngjashëm të furnizimeve të kërkuara sipas kësaj kontrate në shtojcën 8 të DST Specifikimet Teknike. KVO thekson se zërat që nuk janë realizuar janë thelbësorë për të vërtetuar kapacitetin teknik dhe besueshmërinë se subjekti është në gjendje të përmbushë këto furnizime, pasi artikujt për të cilët nuk ka asnjë eksperiment të ngjashme , lidhen me funksione mjaft të rëndësishme spitalore si dyshekët spitalorë, këllëfët e gomuar të dyshekëve, pandofla pacienti dhe personeli, të cilat kanë kërkesa të vecanta të Cilësisë dhe Standarte CE të përcaktuara me impakt në jetën dhe shëndetin e pacientëve dhe të stafit mjekësor.

3.Nuk plotëson dhe nuk vërteton me dokumentacion kapacitetin teknik të kërkuar sipas pikës 2.3.4 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim, për këto arsye: Arsyetimi Në pikën 2.3.4 Kërkesat e Vecanta për Kualifikim është kërkuar “Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë si më poshtë: -SSH EN 14065:2016 mbi “Sistemin e kontrollit të Biokontaminimit”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme; Për këtë pikë kualifikuese seicili nga antaret e BOE Kombi Invest sh.p.k & Gentian Sadiku P.f paraqitën certifikatën EN ISO 14065:2016 të lëshuar nga AQS CERT Shqipëri. Në kuadër të kompetencave për verifikimin e informacionit të ofertës nga OE pjesëmarrës, KVO kreu verifikimin e Certifikatës ISO 14065:2016 nga AQS Cert, në faqen zyrtare të Drejtorisë të Përgjithshme të Akreditimit Shqipëri (DPA), nga ku rezultoi se subjekti AQS CERT Shqipëri, që ka lëshuar Certifikimin në emër të antarit të BOE Kombi Invest sh.p.k , nuk është i Akredituar për Certifikimin EN ISO 14065:2016 me objekt “Shërbime Lavanderie” Për këtë arsye Operatori Ekonomik nuk i përmbush kërkesat ligjore për Certifikimet e kërkuara në procedurën e prokurimit, për sigurimin e standarteve të cilësisë sipas Nenit 79 pika 1 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, ku përcaktohet: Neni 79 pika 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt

prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit"

- Komisioni publikon pretendime nga ankimuesi për leninen të skualifikuar të operatit ekonomik UNIVERS SERVIS sh.p.k

* Formulari Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 12)

*2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë dokumentacion teknik mbi produktin lares që do të përdoren për larjen e materialeve të buta "me ndotje spitalore" sipas klasifikimit në Termat e References shtojca 10 e DST:

-Material i kontaminuar"

-Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare.

-Material i konsideruar "me rrezik mikrobiologjik"

-Material i pisët"

Për detergjentet e pastrimit Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

I. Skedat teknike ose katalog të lëshuar nga prodhuesi i produktit, shoqëruar me Certifikatën e Konformiteti ose Cilesia CE për keto lloj produktesh.

II. Autorizim/Dokument ekuivalent lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, me anë të cilit vërtetohet se ofertuesi ka siguruar furnizim të rregullt të detergjentëve që do të përdoren për larjen e materialeve të buta "me ndotje spitalor"

III. Tabelen me produktet dhe emertimet që do të përdoren si me poshte vijon:

Materialet e pastrimit				QSRB
Nr.	Emërtimi i produktit që do të lahet	Vendi i origjines së produktit të pastrimit	Lloji/Emertimi i detergjentit	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent akredituar
1	Material i kontaminuar			
2	Materiali i kontaminuar, nga një pacient pas ekzaminimit në mjeksinë nukleare			
3	Material i konsideruar "me rrezik mikrobiologjik"			
4	Material i pisët"			

*2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

---Operatori ekonomik UNIVERS SERVIS sh.p.k. nuk përmbush kriterin e kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.7 të Dokumenteve të Tenderit. Nga Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit (Shtojca 12) rezulton se makineritë dhe pajisjet e deklaruara nuk korrespondojnë me kërkesat e Autoritetit Kontraktor, pasi për një pjesë të tyre emërtimi i deklaruar nuk përputhet me emërtimin e kërkuar në kriterin 2.3.7 të Dokumenteve të Tenderit, ndërsa për një pjesë tjetër pajisjet e deklaruara nuk përmbushin kapacitetin minimal të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor. Për rrjedhojë, operatori ekonomik nuk provon disponimin e makinerive dhe pajisjeve në përputhje

---Operatori ekonomik UNIVERS SERVIS sh.p.k. nuk përmbush kriterin e kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.9 të Dokumenteve të Tenderit. Konkretisht, ndonëse Autoriteti Kontraktor ka kërkuar shprehimisht që për detergjentët e pastrimit të paraqiten skedat teknike ose katalogët e lëshuar nga prodhuesi, të shoqëruar me Certifikatën e Konformitetit ose Certifikatën e Cilësisë CE për secilin produkt, operatori ekonomik nuk ka paraqitur Certifikatën e Konformitetit ose Certifikatën e Cilësisë CE për çdo produkt të ofertuar. Për rrjedhojë, dokumentacioni teknik i paraqitur nuk përmbush kërkesat e pikës 2.3.9 të Dokumenteve të Tenderit, çka përbën një arsye shtesë për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 03.08.2026

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Gjergj Mersini	Edvin Simo	Nertil Kanina
	Kryetar	
	Ismail Shehu	